

VENDIM
Nr.710, datë 18.10.2006

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË GREQISË, PËR
BASHKËPUNIM NË FUSHËN E ENERGJISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve e marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e Marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Grekisë, për bashkëpunim në fushën e energjisë.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

MARRËVESHJE

**NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË
REPUBLIKËS GREKE, PËR BASHKËPUNIMIN NË FUSHËN E ENERGJISË**

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Greke (këtu individualisht quhen “Pala” dhe bashkërisht Palët):

duke sjellë ndër mend miqësinë, bashkëpunimin, fqinjësinë e mirë dhe Marrëveshjen e Sigurisë të nënshkruar më 21 mars 1996;

duke sjellë ndër mend bashkëpunimin nëpërmjet pjesëmarrjes së tyre në Komunitetin e Energjisë;

duke sjellë ndër mend bashkëpunimin e tyre nëpërmjet pjesëmarrjes së tyre në BSEC;

duke theksuar se bashkëpunimi do të mbështetet kudoherë mbi baza respekti dhe respektimin e parimeve dhe rregullat e së drejtës ndërkombëtare;

duke synuar shtrirjen e bashkëpunimit të tyre në sektorin e energjisë, me qëllim rritjen e bashkëpunimit në sektorët e naftës, gazit natyror dhe energjisë elektrike;

duke njohur vendimin e Bashkimit Europian nr.1229/2003/EC për zhvillimin e rrjeteve transeuropiane të energjisë,

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Objekti i kësaj Marrëveshjeje është ngritja e kuadrit për bazën e bashkëpunimit ndërmjet palëve në fushën e naftës, gazit natyror dhe energjisë elektrike.

Neni 2

Palët do të vlerësojnë dhe njohin mundësinë e transferimit dhe shitjes, nëpërmjet tubacioneve, të gazit natyror nga Greqia në Shqipëri dhe anasjelltas dhe do të studiojnë kushtet përkatëse.

Neni 3

Palët do të shkëmbejnë informacionin e duhur që mund të jetë me interes për to dhe mund t’i ndihmojë ato për të marrë vendimet në lidhje me objektivat e mësipërme.

Neni 4

Palët do të themelojnë një komitet të përbashkët të përbërë nga përfaqësues të të dyja Palëve, me qëllim që të shqyrtojnë objektivat e përcaktuara në nenet 2 dhe 3. Komiteti i përbashkët do të mblidhet në Athinë ose në Tiranë. Për vendin dhe datën e takimeve të komitetit të përbashkët do të bihet dakord nga të dyja Palët nëpërmjet

kanaleve diplomatike. Takimi i parë i komitetit të përbashkët do të zhvillohet brenda 2 (dy) muajve nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje. Komiteti i përbashkët do t'u paraqesë përfundimet e studimit të tij autoriteteve përkatëse për të vendosur mbi to.

Neni 5

Marrëveshja do të jetë e vlefshme për një periudhë prej pesëmbëdhjetë (15) vjetësh, duke filluar nga data e hyrjes së saj në fuqi. Marrëveshja shtyhet automatikisht për një periudhë tjetër pesë (5) vjeçare, nëse njëra prej Palëve nuk njofton tjetrën me shkrim të paktën gjashtë (6) muaj përpara datës fillestare të skadimit ose çdo periudhe të mëpasshme të vlefshmërisë, në lidhje me synimin e saj për ta përfunduar këtë Marrëveshje.

Neni 6

Marrëveshja hyn në fuqi me marrjen e njoftimit të fundit me shkrim, nëpërmjet kanaleve diplomatike, nëpërmjet të cilit Palët informojnë njëra-tjetrën në lidhje me përfundimin e procedurave të tyre të brendshme përkatëse që kërkohen për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

Bërë në Athinë, më 13 shtator 2006, në dy kopje origjinale, secila në gjuhët shqipe, greke dhe angleze. Në rast mospërputhjeje në interpretim, mbizotëron teksti në gjuhën angleze.

PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Genc Ruli
MINISTRI I EKONOMISË, TREGTISË DHE
ENERGJETIKËS

PËR QEVERINË E REPUBLIKËS GREKE
Dimitris Sioufas
MINISTËR I ZHVILLIMIT